

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kusari-Lila pas tërheqjes së Sejdiut: Pa marrëveshje për presidentin, Kosova mund të shkojë sërish në zgjedhje
ADRESA	https://albeu.com/kosove/kusari-lila-pas-terheqjes-se-sejdiut-pa-marreveshje-per-presidentin-kosova-mund-te-shkoje-serish-ne-zgjedhje/1011642/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 19:59:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 19:52:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6f2e8703bf70ca3158d0cb1284998044b0c8df9ec4e62d134d59fc7ae4f83e9b
TEKSTI	d347514bab77ce553ec7f9f00704ebc7dd3a3f70efbe9c5e1a11c834f7fa8134
PAMJA	174cee44a4f08e873f843aee15005d4193284f8c591b260b8ed9f07e44a4fd5e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7356655fba1990318c04e182ff19909cd0bc695bd77d2e65ced3114eeaf79ee8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	49912a82e108233a2f4c1eb29c0feee4310e444550233db1ec41850f1c69f554
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7356655fba1990318c04e182ff19909cd0bc695bd77d2e65ced3114eeaf79ee8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kusari-Lila pas tërheqjes së Sejdiut: Pa marrëveshje për presidentin, Kosova mund të shkojë sërish në zgjedhje



Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka reaguar pas vendimit të Bekim Sejdiut për të hequr dorë nga kandidatura për president të Republikës së Kosovës. Ajo e ka cilësuar këtë zhvillim si dëshmi të ndarjeve të thella dhe të gjendjes së rënduar të sistemit politik në vend.

Deputetja e Vetëvendosjes, e cila është pjesë e koalicionit parazgjedhor me VV-në, ka shkruar në Facebook se Sejdiu u propozua nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe mori mbështetjen e koalicionit të Lëvizjes Vetëvendosje. Sipas saj, mungesa e konsensusit e ka dëmtuar rëndë procesin.

"Tërheqja e Prof. Bekim Sejdiut nga gara për President, pasi u propozua nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe u mbështet nga koalicioni i Lëvizjes Vetëvendosje, tregon edhe një herë për hendekun e madh dhe sistemin e lënduar politik në vendin tonë", ka shkruar Kusari-Lila.

Ajo ka deklaruar se paaftësia për të kapërcyer përplasjet politike, edhe kur vihet në rrezik funksionimi i shtetit, dëshmon mungesë të theksuar pjekurie dhe qëndrueshmërie në politikë.

Kusari-Lila ka vlerësuar se pasojat e kësaj qasjeje nuk kufizohen vetëm te subjektet politike, pasi koston e saj e përballojnë edhe qytetarët dhe vetë shteti i Kosovës.

Sipas saj, dakordësimi për kandidaturën e Sejdiut nuk lidhet me një post personal apo me interesa partiake, por me ruajtjen e stabilitetit institucional dhe respektin ndaj detyrës së presidentit.

"Marrëveshja për Prof. Bekim Sejdiun nuk ishte marrëveshje për një pozitë personale. Ishte për një funksion shtetëror. Nuk ishte për përfitim partiak, por për stabilitetin institucional dhe dinjitetin e zyrës së Presidentit të Republikës", ka thënë ajo.

të fundit /



Kusari-Lila pas tërheqjes së Sejdiut: Pa marrëveshje për...



Taulant Seferi shkëlqen në Turqi, arrin kuotën e shtatë golave



Rrëzohet një avion privat në Gjermani, humbin jetën tre...



Pas largimit të Sejdiut nga gara presidenciale, Ymeri: Rroftë LDK-ja...



Denoncimi i Ahmetajt/ Përgjimi i ri i Ron Yeffet: Mos dërgoni letra në...



Agjenti i Endrickut mohan largimin e mundshëm nga Real...



Koncepti elektrik i Volkswagen synon mbi 1,400 kilometra...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Kryetarja e Alternativës ka theksuar gjithashtu se Sejdiu kishte përvojë akademike, integritet në aspektin personal dhe profesional, si dhe vullnet për ta marrë përsipër këtë përgjegjësi në një periudhë të ndjeshme për vendin.

Ajo ka bërë të ditur se tërheqja e tij, e ardhur pas rënies së mundësive për arritjen e një marrëveshjeje, duhet parë më shumë si humbje dhe dëmtim për shtetin sesa si triumf i një grupimi politik ndaj tjetrit.

"Me këtë tërheqje kemi humbur të gjithë. Dhe nëse nuk gjendet një marrëveshje për Presidentin, vendi po rrezikon me shpejtësi të rikthehet sërish te zgjedhjet", ka deklaruar Kusari-Lila.

"Kosova", ka shtuar ajo, "nuk ka nevojë që një parti të mposhtë tjetrën, por që shteti të dalë mbi inatin politik".

Në përmbyllje, Kusari-Lila e ka falënderuar Sejdiun për gatishmërinë që tregoi për t'i shërbyer vendit në një moment të vështirë. Ajo i ka uruar sukses në angazhimet e tij profesionale, akademike dhe personale.

Bekim Sejdiu njoftoi se po largohej nga gara për president të Republikës së Kosovës për shkak të mungesës së mbështetjes së nevojshme në Kuvend dhe pasi procesi ishte përfshirë në përplasje të brendshme politike.

Shtuar më 14.09.2026 21:52

Tags: [mimoza kusari](#) , [Sejdiu](#) , [Tërheqja](#)



Mërgim Lushtaku: Kosova duhet të jetë e gatshme të mbrojë Republikën në ra...



Pas largimit të Sejdiut nga gara presidenciale, Ymeri: Rroftë LDK-ja dhe...



Nagavci: Tërheqja e Sejdiut është humbje për procesin e zgjedhjes së presidentit



Bekim Sejdiu tërhiqet nga gara për President të Kosovës: Partitë të dalin...



Ceta kërkon protestë për viktimat e pasluftës në Kosovë: Drejtësia duhet t...



Rustem Mustafa propozon "Koalicionin për Normalitet" për funksionalizimin e...



Gola: Lirimi i katër ish-drejtimesve të UÇK-së do të ishte sukses i Kosovës, j...



Gjashtë projekte Kosovë-Maqedoni e Veriut marrin financim prej 3.24 milionë...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.